



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin Hashim *Thaçi dhe të tjerët*, dëshmitari i pestë, i gjashtë dhe i shtatë, të thirrur nga Prokuroria, përfunduan dëshmitë e tyre këtë javë. Një pjesë e dëshmimeve u dha në seancë private dhe një pjesë në seancë publike. Vendimi i Trupit Gjykes për t'i mbajtur disa pjesë të gjyimit në seancë private merret rast pas rasti dhe arsyeja kryesore është mbrojtja e sigurisë dhe identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave.

Me mbarimin e dëshmisë së dëshmitarit të shtatë të martën, seancat gjyqësore përfunduan për këtë javë dhe do të rifillojnë të hënën, më 12 qershor në orën 09:00.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 18 maj Trupi Gjykes miratoi pjesërisht mocionin e përbashkët të ekipeve të Mbrojtjes me të cilin i kërkuan Trupit Gjykes të bëjë konstatim gjyqësor për disa fakte të gjykuara më parë nga gjykata në Kosovë dhe TPNJ-ja. Rregullorja e lejon këtë, për të shkurtuar kohën që nevojitet për paraqitjen e provave që lidhen me fakte të gjykuara më parë në procese të tjera gjyqësore. Prokuroria mund të paraqesë gjatë gjyimit prova që kundërshtojnë saktësinë e këtyre fakteve, nëse dëshiron.

Po më 18 maj, Kryetarja e DHSK-së Ekaterina Trendafilova caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të shqyrtuar apelin e paraqitur nga z. Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi lidhur me pyetjen e dëshmitarëve nga Trupi Gjykes. Paneli i Apelit përbëhet nga gjykatësja Mishelë Pikar, gjykatësi Kai Ambos dhe gjykatësja Nina Jorgensen.

Më 23 maj, Trupi Gjykes miratoi kërkesën e Prokurorisë për të shtuar pesë materiale që lidhen me një dëshmitar ekspert në listën e provave materiale të kësaj çështjeje gjyqësore. Ndër to janë një aktekspertizë forenzike e ADN-së dhe një analizë e ADN-së, të përditësuara, lidhur me një viktimë të vvarë që përmendet me emër në Aktakuzë. Lista e ndryshuar e provave materiale të Prokurorisë duhet të dorëzohet deri më 30 maj 2023.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykes, më 17 maj 2023, urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, me vendim përkatës për secilin. Trupi Gjykes konstatoi se ekziston ende rreziku që z. Krasniqi dhe z. Selimi mund të pengojnë ecurinë e procesit gjyqësor ose të kryejnë krime të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë ose do të japin dëshmi në çështjen gjyqësore dhe/ose pritet të paraqiten para Dhomave të Specializuara.

Gjykimi i Pjetër Shalës rifillon të martën, më 30 maj në orën 09:30.





Ekipi i programit për ndërgjegjësim dhe komunikim të DHSK-së ndodhet në Kosovë këtë javë për t'u takuar me studentë dhe shoqëri civile në Prishtinë dhe Mitrovicë. Që prej vitit 2018, ky ekip ka takuar më shumë se 3000 persona në të gjithë Kosovën të cilëve u ka dhënë informacion për Gjykatën, si dhe ka dëgjuar mendimet dhe u është përgjigjur pyetjeve të tyre.

Pyetje nga gazetarët

